



KUVENDI KOMUNAL NË LIPJAN  
ZYRA PËR KOMUNITETE, OJQ YAHR DHE OJQ ASHKANI  
DRAFT / PLANI I VEPRIMIT PËR INTEGRIM TË KOMUNITETIN ROMË DHE  
ASHKANLI NË KOMUNËN E LIPJANIT  
2012/2015

## Shkurtesat

BRK	Buxheti i Republikës së Kosovës
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
DKSHMS	Departamenteve Komunale për Shërbime dhe Mbrojtje Sociale
DMS / MPMS	Drejtoria e Mirëqenies Sociale Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
DPP/MPMS	Departamenti i Punës dhe Punësimit
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSHP	Ministria e Shërbimeve Publike
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MTPT	Ministria e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit
OJQ	Organizata Joqeveritare
PK	Policia e Kosovës
QPS	Qendra e Punëve Sociale
YAHR	Youth Association for Human Rights
UP	Universiteti i Prishtinës
ZKI	Zyra Komunale për Informim
ZKM	Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës
ZQK	Zyra për Çështje të Komuniteteve

## **Hyrje**

Në dhjetor të vitit 2008 Qeveria e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me institucione të ndryshme qeveritare e jo-qeveritare ka hartuar Strategjinë e Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Rom dhe Ashkanli , 2008-2015 si dhe Planin e Veprimit për Zbatimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për Integrimin e Komuniteteve Rom dhe Ashkanli , 2009-2015, dokumente këto që kanë për synim përmirësimin e mirëqenies dhe integrimin e komuniteteve Rom dhe Ashkanli në të gjitha sferat e jetës në Kosovë.

Për t'i bërë këto dokumente më të zbatueshme dhe për t'i "përkthyer" ato në veprime konkrete dhe të prekshme për qytetarët e këtyre komuniteteve, organizata YAHR dhe në bashkëpunim me Zyrën për Komunitete të Komunës së Lipjanit dhe OJQ-të aktive që punojnë me këto komunitete në Komunën e Lipjanit kanë hartuar këtë Plan të Veprimit për Komunën e Lipjanit.

Strategjia dhe Plani i Veprimit të Qeverisë janë hartuar në vija të përgjithshme për tërë Kosovën. Për të përfituar nga kjo Strategji dhe Plan Veprimi secila Komunë e Kosovës duhet të hartoj Planin e Veprimit në harmoni me politikat e Qeverisë por duke marr parasysh specifikat e komunës ku jetojnë këto komunitete. Si rezultat, Komuna e Lipjanit ka një Plan Veprimi që ka për synim bërjen e hapave konkret për integrim të Komuniteteve.

Statistikat që lidhen me këto dy komunitete janë të paqarta dhe shpesh të pasakta ose kontradiktore. Por megjithatë mendohet se rreth diku rreth deri 3.000 romë, ashkalijë jetojnë aktualisht në Komunën e Lipjanit dhe kryesisht të fokusuar në këto vendbanime: Lipjan, Magure, Dobrajë e Vogël, Hallaq i Vogel, Sllovi, Konjuh, Medvec, Gadime dhe në Janjevë.

### **Plani i Veprimit fokusohet këto fusha:**

- 1. edukimi,**
  - 2. punësimi dhe fuqizimi ekonomik,**
  - 3. shëndetësia dhe çështjet sociale,**
  - 4. strehimi dhe vendbanimet jo-formale,**
  - 5. kthimi dhe ri-integrimi,**
  - 6. regjistrimi,**
  - 7. kultura, media dhe informimi,**
  - 8. pjesëmarrja dhe përfaqësimi,**
- siguria, shërbimi policor dhe drejtësia.**

Pra, ky Plan Veprimi ruan strukturën organizative të Planit të Veprimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës por veprimet e identifikuar janë

bërë për Komunën e Lipjanit në veçanti. Rrjedhimisht, Plani i Veprimit është formuluar nga lart (Strategjia dhe Plani i Veprimit të Qeverisë) dhe nga poshtë, pra, nga të dhënat e mbledhura nga YAHR, Zyra për Komunitete dhe OJQ-të aktive në komunën e Lipjanit si: “YAHR”, OJQ “Ashkani” dhe “BSF”. Kjo ka mundësuar identifikimin e nevojave të Komuniteteve dhe inkorporimin e tyre në këtë Plan Veprimi.

## **Metodologjia**

Pikënisje e hartimit të këtij Plani ka qenë qasja e legjislacionit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës ndaj komuniteteve. Përveç ligjeve, kjo qasje është e shprehur edhe me Strategjinë dhe Planin e Veprimit të hartuar nga Qeveria. Synimi kryesor është integrimi i komuniteteve Rom dhe Ashkanli në shoqërinë kosovare duke u mundësuar punësim, arsimim, vendbanime më të mira, dhe kyçje në institucionet shtetërore duke fuqizuar rolin e tyre në vendim marrje.

Sa i përket metodës, teknikave të hartimit të Planit, janë përdorur disa mënyra. Përveç të dhënave të ofruara nga Strategjia dhe Plani i Veprimit të Qeverisë janë përdorur edhe të dhënat nga Zyra Komunale për Komunitete, si dhe janë aplikuar pyetësor. Kjo ka ndihmuar në përcaktimin e prioriteteve. Ndërkaq, pyetësorët kanë qenë të drejtuar ndaj institucioneve përkatësisht drejtorive lidhur me planet dhe projektet që prekin komunitetet në sektorët përkatës. Kjo ka ndihmuar në harmonizimin e veprimeve dhe ikjes së dyfishimit të punës. Po ashtu, pyetësorë janë realizuar edhe me banorët e vendbanimeve Rom dhe Ashkanli, me qëllim të identifikimit të problemeve me të cilat ballafaqohen ata. Të gjitha njohuritë e marra nga terreni janë harmonizuar dhe janë listuar në aktivitete.

## **Arsimi**

Legjislacioni i aplikuar në Kosovë parashikon të drejta gjithëpërfshirëse dhe të veçanta për shkollimin e komuniteteve jo-shumicë. Këtu përfshihen e drejta për vijim në shkolla publike në të gjitha nivelet, në njërin prej gjuhëve zyrtare (shqipe ose serbe). Në zonat e banuara me persona që i përkasin komuniteteve, gjuha amtare e të cilëve nuk është gjuhë zyrtare, këta persona që ju takojnë këtyre komuniteteve kanë të drejtë të shkollimit publik në nivelin parashkollor dhe para-fillor, fillor dhe të mesëm, në gjuhën e tyre amtare. Aty, ku për shkak të numrit të pamjaftueshëm të nxënësve ose për ndonjë arsye tjetër, nuk ofrohet mundësia e shkollimit në gjuhën e zgjedhur zyrtare ose të komunitetit, duhet të sigurohen alternativa tjera. Në komunën e Lipjanit të drejta e shkollimit në gjuhën amtare e garantuar me legjislacionin në fuqi (për komunitetin Rom) nuk është zbatuar deri më tani për shkak të kushteve të ndryshme.

Gjendja e arsimimit të komuniteteve Rom dhe Ashkanli në komunën e Lipjanit si edhe në komunat e tjera të Kosovës nuk është në nivelin e kënaqshëm. Braktisja e mësimin, sidomos nga gjinia femërore, vazhdon të jetë ndër problemet kryesore, megjithëse braktisja edhe tek gjinia mashkullore është në nivel të lartë krahasuar me komunitetet e tjera që jetojnë në këtë komunë. Nga anketa me 200 respondentë të gjithë kanë përmendur gjendjen e vështirë ekonomike si faktor kryesor të braktisjes së mësimin nga nxënësit. Për arsye të ndryshme siç janë kushtet e

vështira financiare, niveli i ulët i vetëdijes për rëndësinë e arsimit, martesat e hershme tek femrat, mungesa e teksteve shkollore në gjuhën romë, mungesa e bursave (për të gjitha komunitetet shumicë dhe pakicë), mos përmbushja e kriterëve për pranim në shkolla të mesme përkatësisht në drejtimet ku nxënësit dëshirojnë të regjistrohen meqenëse tanimë ekziston udhëzimi i MASHT që asnjë nxënës të mos mbetet jashtë shkollave të mesme por edhe në universitet ndikojnë në përfshirje të vogël të komuniteteve në sistemin arsimor të Kosovës. Shumë nxënës ndërprejnë shkollimin e tyre formal qoftë në shkollë fillore, ose nuk vazhdojnë në shkollë të mesme e më tutje në arsimin e lartë si rezultat i arsyeve të lartpërmendura. Numri i nxënësve të cilët marrin pjesë në arsimin e mesëm dhe atë të lartë është shumë i ulët në krahasim me numrin e nxënësve që kryejnë shkollën fillore nga radhët e komuniteteve të tjera. Analfabetizmi, vazhdon të jetë prezent tek një numër i caktuar i pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkanli , sidomos tek femrat edhe pse në krahasim me vitet e kaluara mund të thuhet se ka potencial të kënaqshëm për përmirësimin e kësaj gjendjeje në vitet e ardhshme. Po ashtu, nataliteti i madh, te disa banorë me arsyen për të aplikuar për ndihmë sociale si burimin e vetëm të të ardhurave të këtyre familjeve të komuniteteve Rom dhe Ashkanli , vazhdon të jetë një shqetësim, ngase fëmijët e lindur nuk gëzojnë kujdesin e nevojshëm si në aspektin shëndetësor ashtu edhe atë edukativo-arsimor. Në të njëjtën kohë, në disa raste infrastruktura shkollore po ashtu nuk plotëson kushtet e nevojshme për edukim cilësor, shkollat nuk kanë rrethoja, parqe dhe fusha sportive, klasat janë të *stër*-vjetruara dhe të tej mbushura me nxënës, gjë që ndikon edhe në mësim-nxënie të ulët megjithëse ky problem pritet të zgjidhet së shpejti me krijimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së re shkollore dhe asaj ekzistuese.

### **Shëndetësia dhe çështjet sociale**

Sa i përket shëndetësisë komunitetet Rom dhe Ashkanli ballafaqohen me probleme të shumta. Fushata vetëdijesimi veçanërisht me nënat për planifikimin familjar, për higjienën personale, kujdesin ndaj fëmijëve të porsalindur janë nevoja imediate. Koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të QKMF-së dhe organizatës OJQ-ve duhet të vazhdoj për ofrimin e këshillave për banorët e komuniteteve për çështje të shëndetësisë dhe për adresat e duhura ku të drejtohen për probleme të ndryshme.

### **Punësimi dhe zhvillimi ekonomik**

Mungesa e punësimit të banorëve të Komuniteteve Rom dhe Ashkanli në komunën e Lipjanit është problemi kryesor i qytetarëve të këtyre komuniteteve. Sidoqoftë arsyeja kryesore për mungesën e punësimit të qytetarëve të Komuniteteve Rom dhe Ashkanli është mungesa e përgatitjes profesionale dhe akademike që lë shumë pak hapësirë për punësimin e tyre në sektorin publik ku kërkohet përgatitje më e madhe profesionale,

## **Kulturë, Rini, dhe Sport**

Zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe sportive është i kufizuar si rezultat i mungesës së infrastrukturës dhe mjeteve financiare. Për të mënjanuar sadopak këto kufizime është e nevojshme mbështetja më e madhe financiare për klubet kulturo-artistike dhe sportive. Duhet të mundësohet realizimi i ushtrimeve të klubeve sportive në Palestrën e Sportit të Qytetit dhe ndërtimi i një terreni dhe qendre të re sportive, në mënyrë që të krijohen kushte të përshtatshme për të gjitha komunitetet.

Përkrahja e aktiviteteve rinore po ashtu është e një rëndësie të veçantë. Në këtë kontekst Komuna e Lipjanit përkatësisht DKRS duhet të punoj në bashkëpunim me OJQ-të lokale edhe në organizimin e programeve kulturo-artistike me pjesëmarrje të madhe të të rinjve për Ditët Festive të parapara me Ligjin mbi Festat Zyrtare të Kosovës meqenëse mungon përfshirja e komuniteteve në këto manifestime.

## **Informimi, përfaqësimi dhe vendim-marrja**

E drejta e Informimit është kategori kushtetuese përmes të cilës gjithsecilit qytetar të Republikës së Kosovës i garantohet qasja në informacionin dhe dokumentacionin zyrtar<sup>9</sup>. Dokumentet e institucioneve të Republikës së Kosovës janë dokumente zyrtare dhe në dispozicion të qytetarëve të Kosovës dhe si të tilla ato janë të qasshme për çdo palë të interesuar. Legjislacioni aktual i Republikës së Kosovës u mundëson qasje në përfaqësim dhe vendim-marrje qytetarëve të Republikës së Kosovës përmes pjesëmarrjes në takimet publike të komunave, iniciativave të qytetarëve për hartimin e rregulloreve apo vendimeve që janë në kompetencë të komunave etj.

## **Siguria, shërbimi policor dhe drejtësia**

Komuna e Lipjanit njihet si një ndër komunat me nivelin më të ulët të problemeve të aspektit etnik, që ndikon jashtëzakonisht shumë në një ndjenjë të mirëfilltë të sigurisë së përgjithshme dhe të besueshmërisë në Policinë e Kosovës sipas anketës me qytetarë. Policia e Kosovës thotë që ankesat eventuale që mund të vinë nga qytetarët e komuniteteve i trajton me më shumë seriozitet dhe tenton të veproj më shpejt por që gjithashtu nuk ka trajtim të ndryshëm se sa për komunitetet e tjera përderisa në komunën e Lipjanit ekziston një frymë shumë e mirë e bashkëjetesës dhe nuk ka probleme etnike. Në Komunën e Lipjanit ekziston Këshilli Lokal për Siguri në Bashkësi, komiteti i cili ka për obligim përcjelljen e situatës së sigurisë së qytetarëve të Lipjanit.

## PLANI I ZBATIMIT

<b>Arsimi</b>				
<b>Qëllimi:</b> Ndërtimi i sistemit arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës, të bazuar në drejtësi, barazi dhe respekt për diversitetin(shumëllojshmërinë), që i kontribuon integritet të plotë të komuniteteve Rom dhe Ashkanli në shoqëri.				
Objektivi 1: Përmirësimi i dukshëm i pjesëmarrjes në arsim dhe i cilësisë së arsimit për pjesëtarët e komuniteteve Rom, Ashkanli dhe Egjiptian.				
Aktiviteti 1: Përfshirja e edukatorëve Rom dhe Ashkanli dhe asistentëve të tyre në institucionet e nivelit para-fillor dhe parashkollor				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 1.1. Hulumentimi i nevojave për arsimin parashkollor dhe para-fillor	IV. 2013	DKA, ZKK, OJQ-të <sup>12</sup>	BK
2.	Veprimi 1.2. Identifikimi i edukatorëve të kualifikuar dhe asistentëve nga radhët e komuniteteve Rom, Ashkanli dhe Egjiptian	IV. 2013	DKA, ZKK, OJQ-të	BK
3.	Veprimi 1.3. Identifikimi dhe trajnimet kualifikuese për edukatorë dhe asistentë të rinj	Vazhdimisht	DKA, MASHT, ZKK	BK
4.	Veprimi 1.4. Kyçja në sistemin arsimor të personelit të kualifikuar nga radhët e Komuniteteve Rom dhe Ashkanli	Vazhdimisht	DKA, ZKK	BK
5.	Veprimi 1.5. Publikim i Raportit Huluntues	I. 2014	DKA, ZKK	BK
Aktiviteti 2: Ofrimi i programeve ri-integruese për fëmijët e kthyer nga diaspora				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 2.1. Identifikohen familjet e kthyer nga jashtë në bazë të Strategjisë për Kthim dhe Ri-integrim të Komunës së Lipjanit	Vazhdimisht	ZKK, DKA, OJQ-t ë	BK
2.	Veprimi 2.2. Ofrohen kurse gjashtë mujore për gjuhën e vendit (shqipe dhe serbe)	Vazhdimisht	DKA, ZKK, OJQ-të	BK

3.	Veprimi 2.3. Ofrohen kurse të gjuhës shqipe për nxënësit Rom që shkollimin fillor e kanë mbaruar në gjuhën serbe por që shprehin vullnetin të vazhdojnë shkollën e mesme në gjuhën serbe	Vazhdimisht	DKA, ZKK, OJQ-të	BK
5.	Veprimi 2.5. Nostrifikimi i dokumentacionit shkollor	Vazhdimisht	DKA, ZKK,	BK
Aktiviteti 3: Motivimi për pjesëmarrje të shtuar në arsim				
		IV. 2011	DKA, ZKK,	BK
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 3.1. Organizimi i fushatës së ndërgjegjësimit për prindër për regjistrimin me kohë të fëmijëve në shkollë	II. 2013 III. 2014 II. 2015	ZKK, DKA, OJQ-të	BK
2.	Veprimi 3.2. Identifikohen nevojat e nxënësve që nuk vijnë në mësimin me rregull	Vazhdimisht	DKA, ZKKOJQ-të,	BK
3.	Veprimi 3.3. Ofrohet shërbimi i transportit falas për fëmijët që udhëtojnë më se 2 km në ditë	Vazhdimisht	DKA, ZKK	BK
4.	Veprimi 3.4. Ofrohen çanta dhe veshmbathje për kategoritë më të varfra	Vazhdimisht	DKA, ZKK,	BK
			Donator ë	
5.	Veprimi 3.5. Ofrohen tekste dhe materiale shkollore falas	Vazhdimisht	DKA, ZKK	BK
6.	Veprimi 3.6. Ofrimi i orëve plotësuese në shkollë dhe jashtë shkollës për nxënësit me vështirësi në të nxën <sup>15</sup> ë	Vazhdimisht	DKA, OJQ-të	BK, Donatorë
7.	Veprimi 3.7. Caktohen mësimdhënësit që punojnë me nxënësit me vështirësi në të nxënë.	IV. 2013	DKA	BK
Aktiviteti 4: Krijimi i kushteve për vazhdimin e arsimimit pas shkollimit të obligueshëm				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti



1.	Veprimi 4.1. Themelimi i fondit për bursa (ky fond do të ndihmoj në koordinimin e dhënies së bursave nga institucione të ndryshme qeveritare e jo-qeveritare dhe do të sigurohet që një numër sa më i madh i nxënësve është përfitues)	IV.2013	DKA, OJQ-të	BK, Donatorë
2.	Veprimi 4.2. Themelimi i Komisionit të përbashkët të përbërë prej komunitetit, institucioneve dhe organizatave të ndryshme për koordinimin e aktiviteteve vetëdijesuese për rëndësinë e shkollimit)	IV.2013	DKA, ZKK, OJQ-të	BK
3.	Veprimi 4.3. Organizohen fushata ndërgjegjësimi për vazhdimin e shkollimit	II.2013 II.2014 II.2015 II.2013	DKA, ZKK, OJQ-të	BK
Aktiviteti 5: Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin e rregullt arsimor				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 5.1. Identifikohen fëmijët me nevoja të veçanta	III. 2013 dhe Vazhdimisht	ZKK, DKA, OJQ	BK
2.	Veprimi 5.2. Raportim dhe koordinim i punës me MASHT për veprimet e mëtejshme	Vazhdimisht	DKA	BK
Aktiviteti 6: Parandalimi i segregacionit dhe diskriminimit me akte ligjore				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 6.1. Ri-funksionalizimi i Këshillit Prind-Arsimtarë	IV – 2013	DKA, Shkollat,	BK, Donatorë
2.	Veprimi 6.2. Raportim i rasteve të segregacionit në institucione komunale dhe polici	Vazhdimisht	OJQ-të, KPA	BK
3.	Veprimi 6.3. Adresim dhe zgjidhje e rasteve të raportuara	Vazhdimisht	DKA, KPA	BK
4.	Veprimi 6.4. Në bashkëpunim me MASHT ofrohen trajnime për mësuesin për mënyrën e parajkykimeve	Vazhdimisht	DKA, MASHT, OJQ-	BK
Objektivi 2: Bashkëpunim cilësor dhe efikas në mes të institucioneve dhe organizatave relevante në funksion të arsimimit të pjesëtarëve të komuniteteve Rom dhe Ashkanli .				

Aktiviteti 1: Aktivitete të përbashkëta me Policinë përkatësisht Njësitin për Bashkëpunim në Komunitet lidhur me sigurinë				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 1.1. Formohet këshilli i sigurisë në nivel komunal. Përbëhet prej DKA, PK, përfaqësuesi i shkollës, i Këshillit të Shkollës, përfaqësuesi i komunitetit/OJQ/ (Këshill është i ndarë nga KKSB)	IV.2013	DKA, ZKK	BK
2.	Veprimi 1.2. Këshilli i Sigurisë identifikon rastet që kanë të bëjnë me cënimin e sigurisë së nxënësve në shkolla	Vazhdimisht	DKA, OJQ, PK	BK
3.	Veprimi 1.3. DKA lidh marrëveshje bashkëpunimi me Policinë e Kosovës, njësitin për Bashkëpunim në Komunitet lidhur me ofrimin e sigurisë së nxënësve në shkolla. Elementë të marrëveshjes janë patrullimi i rregullt, kujdestaria e një polici në hapësirën shkollore aty ku ka raste,	IV. 2013	DKA, PK, ZKK	BK
4.	Veprimi 1.4. DKA dhe Njësia e Policisë për Bashkëpunim me Komunitet zhvillojnë vizita shtëpi më shtëpi për të vendosur komunikim më të mirë me qytetarë	IV. 2013	DKA, PK	BK
5.	Veprimi 1.5. Mbahen takime të rregullta katër-mujore mes DKA, shkollave, PK dhe përfaqësuesve të komunitetit	Vazhdimisht	DKA, ZKK, PK	BK
6.	Veprimi 1.6. Hartohen dhe publikohen raportet gjashtë-mujore	Vazhdimisht	DKA, PK	BK
Aktiviteti 2: Masat për mosrespektimin të ligjit mbi shkollimin e obliguar				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 2.1. Identifikohen nxënësit që kanë braktisur shkollën dhe që nuk vijnë në shkollën rregullisht	Vazhdimisht	DKA, ZKK, OJQ-të	BK
2.	Veprimi 2.2. Organizohen takime informative me komunitetet në lidhje me detyrimet ligjore mbi arsimin e obliguar	IV. 2013 I. 2014 I.2015	DKA, ZKK, OJQ	BK

3.	Veprimi 2.3. Ndërmerren masa ligjore ndaj stafit të shkollës që nuk raporton me kohë rastet e braktisjes dhe mos-vijueshmërisë me rregull	Vazhdimisht	DKA	BK
Aktiviteti 3: Ofrohen programe ekzistuese për zvogëlimin e shkalles se analfabetizmi – përkrahje institucionale				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 3.1. Identifikohen partneret qe ofrojnë programe të licencuara kundër analfabetizmit	III.2013	DKA, ZKK, OJQ-të	-
2.	Veprimi 3.2. Identifikohen individët qe nuk kane vijuar shkollën	I.2014	DKA, ZKK, OJQ	-
3.	Veprimi 3.3. Organizohen takime me grupet e identifikuar me qellim të informimit për mundësitë lidhur me zhdukjen e analfabetizmit	II.2014	DKA, ZKK	-
4.	Veprimi 3.4. Ne kuadër të qendrave të komunitetit organizohen kurse vetëm për femra	II.2014	DKA, ZKK,OJQ	-
Aktiviteti 4: Krijimi i qendrës burimore në nivel komunal				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	
1.	Veprimi 4.1. Koordinim i punës me OJQ-të, në mënyrë që të studiohen programet ekzistuese të kurikulit jashtë-shkollor dhe krijimi i Qendrës Burimore të Arsimit	III.2013	DKA, ZKK, OJQ	-
2.	Veprimi 4.2. Ofrojnë ore plotësuese për nxënësit e shkollës fillore	Vazhdimisht	DKA, ZKK, OJQ	-
3.	Veprimi 4.3. Kurse të ndryshme për pjesëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkanli	Vazhdimisht	DKA, ZKK, OJQ	-
4.	Veprimi 4.4. Ofrojnë programe për zhdukjen e analfabetizmit	Vazhdimisht	DKA, ZKK	-
5.	Veprimi 4.5. Përfshirja e prindërve ne aktivitetet e qendrës	Vazhdimisht	DKA, drejtoritë e shkollave	-
Aktiviteti 5: Organizohen aktivitete kulturore sportive				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti

1.	Veprimi 5.1. Formohet grupi kulturor i shkollave në përbërje të mësimitdhënësve, nxënësve dhe prindërve	IV.2013	DKA, Shkolla, ZKK	Nuk kërkohen
2.	Veprimi 5.2. Formohen grupet sportive në shkollë në formë të klubeve sportive multi-entike	IV. 2013	DKA, Shkolla, ZKK	Nuk kërkohen
3.	Veprimi 5.3. Hartohet plani shkollor për aktivitetet kulturore dhe sportive me karakter multi-etnik duke përfshirë këtu edhe realizimin e aktiviteteve kulturore për Ditën e Romëve me 8 Prill dhe Ditën e Ashkanlive me 15 Shkurt, ditë këto të parapara me Ligji për Festat Zyrtare të Kosovës	IV.2013	DKA, Shkolla, Grupet e Formuara, OJQ	Nuk kërkohen
4.	Veprimi 5.4. Caktohen përgjegjësit për realizimin e aktiviteteve sipas planit të hartuar	IV. 2013	DKA, Shkolla, Grupet e Formuara, OJQ	Nuk kërkohen
5.	Veprimi 5.5. Caktohet buxheti për aktivitetet e parapara në planin e hartuar	IV. 2013	DKA, Shkolla, Grupet e Formuara	Nuk kërkohen
6.	Veprimi 5.6. Organizohen aktivitete kulturore në përputhje me interesat e komuniteteve	Vazhdimisht - në bazë të planit të hartuar	DKA, Shkollat, Grupet e Formuara,	Donatorë të ndryshëm
7.	Veprimi 5.7. Komuna në bashkëpunim me OJQ-të gjejnë fonde për programet e asistencës në mësim-nxënie	Vazhdimisht	Zyra e Kryetarit dhe OJQ-të	Donatorët

## **Punësimi dhe Fuqizimi Ekonomik**

***Qëllimi: Punësim dhe përmirësim i situatës ekonomike për të gjithë anëtarët e komuniteteve Rom dhe Ashkanli .***

Objektivi: Rritje e nivelit të punësimit të individëve nga komunitetet Rom dhe Ashkanli përmes ndërmjetësimit, aftësimin profesional dhe punësimit në punët e sektorit publik dhe sektorin privat

Aktiviteti 1: Hartimi dhe zbatimi i programeve të reja dhe ekzistuese për aktivizimin e krahut të lire të punës nga të tri komunitetet				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 1.1. Rritja e bashkëpunimit në mes të Entit për Punësim dhe komuniteteve/ofrimi i informatave për programet dhe ofrimi i lehtësimeve për pjesëmarrje në programe	Vazhdimisht	Enti për punësim, Komuna dhe OJQ-të	
2.	Veprimi 1.2. Enti për punësim në bashkëpunim me OJQ-të e komuniteteve të përpiloj dhe të aplikoj te donatorë të ndryshëm me projekte për punësimin sezonal të pjesëtarëve të këtyre komuniteteve	Vazhdimisht	Enti për punësim, Komuna dhe OJQ-të	
3.	Veprimi 1.3. Zyra Komunale për Barazi Gjinore në bashkëpunim me OJQ që punojnë për të drejta të femrave përpilojnë projekte dhe tentojnë të përfitojnë grante për zhvillimin e bizneseve të vogla për zhvillimin e aftësive të femrave	Vazhdimisht	Zyra për Barazi Gjinore dhe OJQ	
4.	Veprimi 1.4. Ofrimi i mundësisë për marrje të përvojës përmes programeve të internshipit në sektorët e ndryshëm komunal			
5.	Veprimi 1.5.. Punësimi i anëtarëve të tri komuniteteve në punët e sektorit publik (jo më pak se 3%)	Vazhdimisht	Komuna, ZKK, MPMS	–
6.	Veprimi 1.6. Punësim ekskluziv për komunitetet Rom dhe Ashkanli në punë të ndërtimtarisë në qendrat ku banojnë vetë banorët e komuniteteve Rom dhe Ashkanli	Vazhdimisht	Komuna, ZKK	–
<b>SHËNDETËSIA DHE ÇËSHTJET SOCIALE</b>				
<b><i>Qëllimi: Përmirësimi i statusit shëndetësor dhe social, dhe cilësisë së shërbimeve dhe qasjes ndaj sistemit shëndetësor dhe social të Lipjanit, pa diskriminim të komuniteteve Rom dhe Ashkanli</i></b>				
Objektivi 1: Krijimi i kushteve cilësore dhe të qëndrueshme higjieno-sanitare dhe mjedis i përshtatshëm për jetë në vendbanimet e komuniteteve Rom dhe Ashkanli				
Aktiviteti 1: Ndërmarrja e aktiviteteve për përmirësimin e kushteve				

higjieno-sanitare , të mjedisit dhe praktikave dhe sjelljeve relevante		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 1.1 Krijimi i Këshillimores për shëndetësi për banorët e komuniteteve	IV – 2013	DSHMS, OJQ-të	
2.	Veprimi 1.2. Krijimi dhe institucionalizimi i Pozitës së Ndërmjetësuesve Shëndetësor	IV - 2013	DSHMS, KFOS, OJQ-të	-
3.	Veprimi 1.3. Sigurimi i ujit të pijshëm kualitativ, , caktimi i lokacionit për hedhjen e mbeturinave në zonat e banuara me banorë të këtyre komuniteteve dhe menaxhimi në mënyrë korrekte i mbledhjes së mbeturinave	Vazhdimisht	Komuna, ZKK, MPMS	-
4.	Veprimi 1.4. Punësimi i specialistëve si kardiolog dhe internist në QKMF jo vetëm për nevoja të komuniteteve por për të gjithë qytetarët duke pasur parasysh vështirësitë financiare për shërim në komunat e tjera	I - 2014		

**Objektivi 2:** Mundësimi marrjes së shërbimeve sociale përmes ndarjes së informacionit, përfshirjes në skemat e ndihmës dhe ofrimit të shërbimeve në formë të barabartë dhe në përputhje me nevojat

**Aktiviteti 1:** Ofrimi i shërbimeve sociale përmes ndërgjegjësimit, informimit dhe përfshirjes në skemat ekzistuese

		Koha/Çereku	Përgjegjës	
1.	Veprimi 1.1. Informimi i komuniteteve për mundësitë e marrjes dhe llojeve të shërbimeve sociale	IV. 2013 II. 2014 III. 2015	ZKK, QPS	Nuk kërkohet
2.	Veprimi 1.2 Ofrimi i ndihmave sociale për komunitetet Rom dhe Ashkanli	Vazhdimisht	MPMS, DSHMS	BK
3.	Veprimi 1.3. Lirimi nga pagesa për shërbime komunale	Vazhdimisht	DSHMS	

## **Kulturë, Rini, dhe Sport**

**Qëllimi:** Komunitetet Rom dhe Ashkanli mund të zhvillojnë dhe promovojnë identitetin e tyre kulturor dhe zhvillimin e aktiviteteve rinore e sportive

Objektivi: Përmirësim i infrastrukturës dhe mundësive financiare				
Aktiviteti 1: Komunat ofrojnë hapësirë për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 1.1. Krijimi i hapësirave të përshtatshme për zhvillim të aktiviteteve kulturore dhe sportive	Vazhdimisht	DKRS, ZKK	BK
2.	Veprimi 1.2. Ofrimi i mundësisë së shfrytëzimit të hapësirës së Palestrës Sportive për aktivitete rinore pa pagesë	IV. 2013	DKRS, ZKK	Nuk kërkohet
3.	Veprimi 1.3. Caktimi i kohës së shfrytëzimit të Palestrës dhe Fushë Sportive nga klubet e komuniteteve	IV. 2013	DKRS, ZKK	Nuk kërkohet
4.	Veprimi 1.4. Shqyrtimi i mundësive për ndërtimin e një stadiumi të futbollit për shfrytëzim të të gjitha komuniteteve (veçanërisht për klubet nga radhët e komuniteteve )	2014	DKRS, MKRS, ZKK	
5.	Veprimi 1.5. Shikohet mundësia e përkrahjes financiare të iniciativave kulturore dhe sportive që vijnë nga komunitetet dhe bëhet ndarja e drejtë e buxhetit komunal për këto aktivitete.	Vazhdimisht	DKRS, ZKK	-
<b>STREHIMI dhe VENDBANIMET INFORMALE</b>				
<b><i>Qëllimi: Krijimi i kushteve për strehim për familjet e kthyer Komuniteteve Rom dhe Ashkanli si dhe lehtësimi i procesit të legalizimit të vendbanimeve informale</i></b>				
Objektivi 1: Ndërtimi i shtëpive për familjet pa strehim dhe rastet sociale dhe lehtësimi i procesit të legalizimit të vendbanimeve jo-formale				
Aktiviteti 1: Identifikimi i familjeve që nuk kanë strehim dhe adresimi i problemeve të këtyre familjeve				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti

1.	Veprimi 1.1. Identifikimi i familjeve që nuk kanë strehim përmes vizitave në zonat ku banojnë komunitetet Rom dhe Ashkanli	Vazhdimisht	ZKK si dhe Grupi Koordinues për Lipjan si dhe Komiteti për Komunitete	Nuk kërkohen
2.	Veprimi 1.2. Adresimi i problemit të strehimit të këtyre familjeve në instancat e tjera komunale e qeveritare dhe identifikimi i donatorëve potencial për ndërtimin e shtëpive	Vazhdimisht	ZKK, Grupi Koordinues për Komunitete, MKK	Nuk kërkohen
3.	Veprimi 1.3. Lehtësimi i procesit të legalizimit të pronave në vendbanimet jo-formale	Vazhdimisht	ZKK, DUKGJ	-
4.	Veprimi 1.4. Ofrimi i asistencës në gjetje të dokumentacionit dhe regjistrim të pronave	Vazhdimisht	ZKK	-
	bashkëpunim me organizatat jo-qeveritare organizojnë takime me bazë komunitare për të minimizuar numrin e foshnjave të paregjistruara që lindin jashtë sistemit shëndetësor		DSH	
7.	Veprimi 1.7. Ri-aktivizim i Bordit Shqyrtues me qëllim të mundësimit të individëve pa dokumente identifikimi të regjistruhen	III. 2013	Komuna	Nuk ka
8.	Veprimi 1.8. Komunitat informojnë me shkrim aplikuesit në rastet kur nuk plotësojnë kushtet e regjistrimit dhe hapat që duhet të ndërmarrin	Vazhdimisht	ZRC	Nuk kërkohen
9.	Veprimi 1.9. Hartohet një formë e njësuar përgjigjeje për aplikuesit që nuk plotësojnë kushtet e regjistrimit	III. 2013	ZRC	Nuk kërkohen
10.	Veprimi 1.10. Komunitat dhe organizatat joqeveritare, lokale dhe ndërkombëtare formojnë grupe pune për monitorimin e veprimeve të mësipërme duke përfunduar me publikimin e raportit	IV. 2013 IV. 2014 IV. 2015	ZKK, Komuna, OJQ	Nuk kërkohen

## Kthimi dhe Ri-integrimi



Objektivi 1: Qeveria e Kosovës siguron shërbime efektive, gjithëpërfshirëse dhe në plotësim të nevojave të individëve të riatdhesuar nga komunitetet Rom dhe Ashkanli , përmes hartimit dhe zbatimit të politikave publike relevante dhe forcimit të koordinimit institucional

Aktiviteti 1: Rritja e efektivitetit të sistemit institucional dhe shërbimeve të ofruara për kthim dhe integrim të qëndrueshëm të të kthyerve nga komunitetet Rom, Ashkanli, dhe Egjiptian		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
		1.	Veprimi 1.1. Komuna siguron që të kthyerit punësohen duke respektuar raportet etnike të popullatës në aktivitete dhe projekte të zhvilluara nga komunat	Vazhdimisht
2.	Veprimi 1.2. Komuna dhe MMPH sigurojnë që veprimet e ndërmarra në çështjet e pronësisë përputhen me kërkesat e prioritetit 31 të PVPE-se	Vazhdimisht	DGJKU	Nuk kërkohen

## Pjesëmarrja dhe Përfaqësimi

**Qëllimi: Rritja e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të komuniteteve Rom, Ashkanli, dhe Egjiptian në jetën publike të Lipjanit**

Objektivi 1: Pjesëmarrje efektive e komuniteteve Rom dhe Ashkanli në jetën publike dhe institucionet vendim-marrëse të Kosovës përmes ofrimit dhe sigurimit të mundësive dhe qasjes së barabartë për tri komunitetet ndaj të gjitha formave të përfaqësimit

Aktivitetet i 1: Monitorim i zbatimit të Ligjit nr.03/L-40 mbi Vetëqeverisjen Lokale në Republikën e Kosovës		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
		1.	Veprimi 1.1. Pjesëmarrje e komuniteteve në baza periodike dhe përcjellje e aktiviteteve të Komiteteve të Komuniteteve	Vazhdimisht
2.	Veprimi 1.2. Përgatitje e raporteve periodike mbi cilësinë e aktiviteteve, përfaqësimin dhe efektivitetin e funksionimit të Komiteteve në përputhje me mandatin e tyre	Vazhdimisht	ZKK dhe Grupi Mbikëqyrës për Implementimin e Planit të Veprimit	Nuk kërkohen

3.	Veprimi 1.3. Nxitje e respektimit dhe ruajtjes së raporteve gjinore	Vazhdimisht	ZKK	Nuk kërkohen
4.	Veprimi 1.4. Komunitat të gjitha informacionet për takime, takime publike, konkurse për punë përveç publikimit në ueb-faqe, shpërndajnë nga një kopje edhe në Qendrën “Fidan Lahu” ku frekuenton një numër i madh i banorëve të komuniteteve, por edhe në lokacione të tjera ku banojnë komunitetet Rom dhe Ashkanli	Vazhdimisht	ZKK, ZKI	Nuk kërkohen
5.	1.5. Funkcionimi më i mirë i ZKK-së në rolin e saj si urë lidhëse në mes të qytetarëve dhe zyrtarëve komunal	Vazhdimisht	ZKK,	

## Media dhe Informimi

### *Qëllimi:* Qasja e barabartë e Komuniteteve Rom dhe Ashkanli në media dhe informacion

Objektivi 1: Krijimi i mundësive për qasje të qytetarëve nga radhët e Komuniteteve në radion lokale

Aktiviteti 1: Krijimi i mundësive financiare për zhvillimin e programeve në radio që i dedikohen problematikave me të cilat përballen Komunitetet Rom dhe Ashkanli

		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 1.1. Sigurimi i fondeve për një emision në radio që do të trajtoj çështjet dhe problemet me të cilat përballen Komunitetet Rom dhe Ashkanli	IV – 2013	ZKK, OJQ-të	Donatorë potencial
2.	Veprimi 1.4. Promovimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare në zonat ku banojnë Komunitetet Rom dhe Ashkanli me qëllim të njoftimit për të drejtat e qasjes në informacionin dhe dokumentacionin zyrtar	IV – 2013	ZKK, ZKI	

## SIGURIA, SHËRBIMI POLICOR dhe DREJTËSIA

<b>Qëllimi: Përmirësim i kushteve të sigurisë për të tri komuniteteve dhe qasja e barabartë e anëtarëve të tyre pranë shërbimit policor</b>				
Objektivi 1: Rritje e efektivitetit të Policisë së Kosovës në parandalimin dhe adresimin e krimeve dhe konflikteve në komunitetet Rom dhe Ashkanli				
Aktiviteti 1: Hartimi i programeve në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe partnerët ndërkombëtar për të ndihmuar në parandalimin e krimeve/konflikteve				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 1.1. Financimi i projekteve për parandalimin e krimit, siguri në trafik dhe konflikteve në bashkëpunim me partnerë lokal e ndërkombëtarë	Vazhdimisht	PK, MPB	BK
2.	Veprimi 1.2. Efektshmëri më e shpejtë e PK-së në thirrjet e Komuniteteve për raste të ndryshme	Vazhdimisht	PK, MPB	Nuk kërkohen
3.	Veprimi 1.3. Vlerësime e sondazhe për matjen e rritjes së besimit të komuniteteve ndaj Policisë së Kosovës	Vazhdimisht	PK, MPB	Nuk kërkohen
Objektivi 2: Të tri komunitetet Rom dhe Ashkanli përfaqësohen pa diskriminim në Policinë e Kosovës dhe në të gjitha Institucionet Publike				
Aktiviteti 1: Punësim i individëve nga të tri komunitetet në Policinë e Kosovës dhe zhvillimi i karrierës së tyre brenda sistemit				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 1.1 Mbajtja e fushatave informuese dhe ndërgjegjësuese për komunitetet Rom dhe Ashkanli për mundësitë e punësimit dhe rekrutimit në Policinë e Kosovës	Vazhdimisht	PK	-
2.	Veprimi 1.2. Hartimi i programeve për përgatitjen e individëve nga të tri komunitetet për marrjen e provimeve pranuese në Policinë e Kosovës	Vazhdimisht	PK	-
3.	Veprimi 1.3. Përzgjedhja e individëve për vendosjen në program duke ruajtur dhe stimuluar përfaqësimin gjinor	Vazhdimisht	PK	-

4.	Veprimi 1.4. Punësimi i oficerëve të policisë nga të tri komunitetet në rajonet e banuara me numër të lartë të Komuniteteve Rom dhe Ashkanli	Vazhdimisht	PK	-
Objektivi 3: Sigurim i qasjes në drejtësi të komuniteteve Rom dhe Ashkanli përmes zbatimit të legjislacionit, monitorimit të praktikave institucionale dhe ndërgjegjësimit				
Aktiviteti 1: Ndërgjegjësimi i komuniteteve mbi të drejtat që ofron Kushtetuta e Kosovës, Ligji Anti-diskriminim, dhe legjislacioni në fuqi				
		Koha/Çereku	Përgjegjës	Buxheti
1.	Veprimi 1.1. Organizimi i aktiviteteve sensibilizuese me të tri komunitetet, përmes fushatave ndërgjegjësuese duke i lidhur me ditë të shënuara kombëtare dhe ndërkombëtare	Vazhdimisht	ZÇK, ZQM - ZKK, OJQ-të	-
2.	Veprimi 1.2. Informimi i Komuniteteve me institucionet ku qytetarët mund të adresojnë problemet dhe ankesat e tyre	Vazhdimisht	ZCK, ZQM, ZKK, OJQ-të	

**Për zbatimin efikas dhe korrekt të këtij Plani të Veprimit janë përgjegjëse të gjitha institucionet e përmendura më lart ndërsa barrën kryesore për koordinimin e aktiviteteve e ka Zyra Komunale për Komunitete nën udhëheqjen e Kryetarit të Komunës. Zyra Komunale për Komunitete është e obliguar që për çdo vitë të kërkojë nga drejtorit komunale të përfshira në këtë plan të veprimit të planifikojnë ndarjen e buxhetit për implementimin e aktiviteteve të parapara në këtë plan të veprimit. Për ta mbikëqyrur realizimin e këtij Plani të Veprimit do të themelohet Grupi Mbikëqyrës për Monitorimin e Zbatimit të Planit të Veprimit për Komunën e Lipjanit. Në këtë Grup Mbikëqyrës do të marrin pjesë zyrtarë komunal nga radhët e komunitetit shumicë dhe komuniteteve Rom dhe Ashkanli si dhe përfaqësues të Shoqërisë Civile, përkatësisht OJQ-ve aktive që punojnë për interesa të Komuniteteve.**